



**Republika e Kosovës Republika Kosova/Republic of Kosovo
Kuvendi Komunal Dragash/Skupština Opštine Dragaš/Dragas Municipality**

**KORNIZA AFATMESME BUXHETORE E KOMUNES DRAGASHIT
2014-2016**

Dragash, 2013

KORNIZA AFATMESME BUXHETORE E KOMUNES DRAGASHIT 2014-2016

I. Hyrje

I. DEKLERATA E DREJTIMIT STRATEGJIK

Korniza Afatmesme e Buxhetore është pëpiluar si vazhdimësi e Kornizesave Buxhetore te viteve paraprake dhe paraqet mjedisin makroekonomik te Komunes .Prezanton një përmbledhje të burimeve të planifikuara qe jane ne dispozicion për financimin e prioriteteve politike te komunës .Komuna e Dragashitne aspektin e zhvillimit është një nder komunat ma pakë te zhvilluara në Republikën e Kosovës me nje normë te ulët te investimeve te bëra qysh ne kohen e paraluftës së fundit dhe me nje numër shumë te madhë te papunëve. Vetëm këto vite të fundit vrehet një aktivitet i shtuar i investimeve nga Qeveria Lokale, Qendrore nga ministrit e linjës dhe donatorve përmes granteve te caktuara për te përmirsuar sado pakë infrastrukturën kominale. Ekonomia e vogël dhe artizanatet zbashku me Ndërmarrjen Ramateks blektorja duhet te janë shtytse e zhvillimit ekonomikë te kësaj komune.

Regjistrimi i fundit dhe ekonomive familjare I organizuar nga enti Statistikor I R Kosoves tregon se komuna e Dragashit ka 35.000 banor (Vlrsimet e OSBS dh UNMIK-ut 35.000 banor ndersa regjistrimi I fundit tregon se numri ibanorve resident do te jete diku mbi 35. 000) ,ka 36 fshatra . Numri i bizniseve te regjistruara eshte 1093.Të punësuar ne këto biznise janë 1557 .Jane Vetem dy kompani që janë Privatizuar(Drateksi ma herët dhe Hotel Shari në kuader te Koritnikut me disa njësi).Në sektorin publik janë të punësuar 795 punëtor. Burim tjetër i të ardhurave janë edhe dyqanet tregtare te cilat drejtohen nga familjarët dhe njerzit kurbeqar te shumt qe punëojn në boten e jashtme në vendet e perendimit. Sa I perket zhvillimit te Komunës mund te themi se ndikimi i krizes ekonomike botrore ka edhe efektet e saja edhe në komunën tonë sidomos ne sferën e dërgesave-remitencave nga diaspora të cilat janë shtyll e fort e mirqenjes se banorve . Për fatë te mirë në vitet e fundit rritja e shpenzimeve kapitale si forcë shtytëse e zhvillimit ekonomik të financuar nga komuna dhe niveli qendror shtetëror ne ndertmin e rrugeve, objekteve shkollore dhe projekteve tjera te infrastruktures ka ndikuar aty ktu në punësimin e nje numri sadopak te punetoreve te kesaj komune .Edhe per kunder ketyre investimeve te bera ,niveli i punesimit është ende shumë i ulët për faktin se për cdo vite numrit të papunëve ju shtohet edhe nje numer i madhe i te rinjve që hyn ne tregun e punes,pas perfundimit te shkollimit para univerzitare dha pas .

Praktikatë kanë treguar se nxitja e investimeve te tilla nga komuna dhe qeveria ka reflektim afatshkurtër ne zhvillimin nëse nuk ka nxitje te investimeve të huja direkte dhe investime vendore nga biznisi egzistues apo mergata e kësaj komune.

Investimet e bëra në komunë te bëra qe nga vitet 2001 e deri me tani ne fushën e infrastrukturës komunale janë bazë e mirë e zhvillimit te komunës dhe qytetarve te saj ,Por, svide e më tejshme për komunën është nevoja per mirmbajtjen e tyre.Duhet të gjindent forma dhe modalitete te reja per menagjimin e tyre me kusht që mos të rriten shpenzimet operative te buxhetit te komunes (mirmbajtja e rrugve ,objekteve shkollore ,ndriqimi elektrik , te Ujësjellsve dhe kanalizimit etj).

Në pergjithësi mirqenja e qytetarve te komunës është në përmirsim te vazhdueshëm dhe synimi i komunës është që te vazhdoj kërkimi i kushteve më të përshtatshem per shtimin e interesimit për investime direkte ne dobi te qytetarve te komunës. Pra ,nevojat mbesin ende shumë te mëdha ne krahasim me mundesit.

a/Struktura Organizative e Komunes Dragashit;

- 160 Kryetari i Komunes
- 169 Kuvendi i Komunes
- 163 Administrata dhe Personeli
- 175 Ekonomi dhe Financa
- 180 Sherbimet Publike ,Mbrojtja Civile dhe emergjenca
- 195 Zyra Lokale e komuniteteve
- 470 Bujqesia ,Pyltari Zhvillimi Rural dhe inspektion
- 650 Gjeodezi Kataster dhe Prone
- 660 Planifikim Urban dhe Mjedis
- 730 Kujdesi Primar Shendetesor
 - Administrata Komunale Shendetesore
 - Sherbimet e kujdesit primar shendetesor
 - Sherbimet Sociale
- 850 Kultura Rinia dhe sporti
- 920 Arsimi
 - Administrata e Arsimit
 - Arsimi Parashkollor
 - Arsimi Fillor
 - Arsimi Mesem-Edukimi sekundar.

Korniza Afatmesme Buxhetore e Komunës së Dragashit është pjese përberese e Kornizës Afatmesme e Shpenzimeve (KASH) te R Kosovës , Strategjisë Zhvillimit Ekonomik te Komunës si dhe synimeve buxhetore të MF-së përmes Qarkores Buxhetore 2014/01.

Korniza Afatmesme Buxhetore është dokument me rendësi te veçante për procesin e zhvillimit te buxhetit që bënë ndërlidhjen e resurseve ne dispozicion me prioritetet e komunës,duke u bazuar ne qendrushmerin e programeve komunale gjatë periudhes se ardhshme 3 vjeçare e mbeshtetur ne LMFP,LFL dhe me udhizimet tjera . Me KAB –Komunale do te paraqiten synimet dhe politikat te mbështetura ne prioritetet e tanishme dhe afatmesme të Komunës së Dragashit si dhe projeksionet ne lidhje me mënyrën me te cilën përcaktohen këto politika me buxhetin e vitit 2014-2016.

Korniza Afatmesme e Buxhetit është një dokument i cili benë lidhjen e proceseve buxhetore te politikë-bërjes lathtë-poshtë dhe caktimin e prioriteteve poshtë lartë në formulimin e buxhetit në komunë.

Korniza paraqet urën lidhese në mese te strategjise zhvillimore komunale e planifikuar permes Planit te zhvillimit te Komunae dhe buxhetit vjetor. Gjithashtu ky planifikim afatemesem i shpenzimeve ka per qellim që te rrisë disiplinën e shpenzimeve te qeverisë lokale karrshi prioriteteve te saja .

Një KAB(KASH) i zbatuar mirë duhet:

- Llidh prioritet e qeverisë me buxhetin brenda një pakoje të qëndrueshme të shpenzimeve;
- Theksohen kompromiset brenda objektivave garues të programeve buxhetore komunale;
- Lidhë buxhetin me zgjidhjet e politikave të bëra
- Përmirësojën rezultatet duke rritur transparencën ,llogaridhënien ne planifikimin dhe shpenzimin e mjeteve buxhetore dhe
- Permbush nevojat e qytetarve karrshi prioriteteve te percaktuara me zhvillimin eekonomik të kësaj komune e sidomos ne krijimin e parakushteve te zhvillimit ekonomik në infrastruktuaren komunale.

II. OBJEKTIVAT E KAB-it KOMUNAL

a. Objektivat e komunës

Me kornizën Afatmesme parashihen te përmbushën këta objektiva:

- a. Infrastruktura fizike dhe mbrojtja e mjedisit
- b. Promovimi dhe mbështetja e biznesit
- c. Ngritja e nivelit të arsimit dhe edukimit
- d. Zhvillimi i bujqësisë dhe blektorise intensive
- e. Shëndetësia dhe mirëqenia sociale
- f. Zhvillimi i turizmit kulturor, historik dhe malor dhe
- g. Ngritja e efikasitetit të administratës locale .

b. Objektivat shtetërore

- Anëtarësimi ne BE përmes procesit dhe instrumentit par-anëtarësim
- Rritja ekonomike
- Qeverisja e mirë
- Kohezioni social
- Zbutja e varfërisë dhe permirsimi i gjendjes ekonomike te qytetarve .

Siq mund te shihen, objektivat e komunes jane te lidhura ngusht me objektivat e Qeverisë të Republikës Kosovës .

Objektivat e secilës drejtori janë parashikuar ne përformancen e tyre.

III. POLITIKAT FISKALE TE KOMUNËS

(SUPOZIMET EKONOMIKE DHE BUXHETORE)

a. Grandi nga Qeveria Qendrore

Korniza Afatmesme Buxhetore është një proces i cili zhvillohet gradualisht e që përsëritet çdo vit dhe ka për qëllim të zvogëlojë mosbalancimin në mes asaj që është e përballueshme dhe asaj çfarë kërkohet në programet e Komunës së Dragashit.

Korniza makroekonomike e Komunes është në përputhje me kornizën makroekonomike të R Kosovës, dhe sipas këti dokumenti , Gjate kësaj periudhe te ndërtimit te KAB-it komunal vëmendje e posaçme i është kushtuar te hyrave nga Grandi i përgjithshëm Komunal dhe nga Grandet specifike për Arsim dhe Shëndetësi, gjersa Grandi i percaktuar ma herët për Sigurim Social nga ky vite,ne vazhdimsi do te financohet nga granti i pergjithshem krahas istrukcioneve te percaktuara me dispozitat ligjore mbi aspektet sociale. Bazuar ne KASH –in e R Kosovës si dhe Qarkoren Buxhetore te Ministrsë Finacave 2014/1.

Korniza makroekonomike e Komunës sipas Qarkores nr. 2013/01

Buxheti sipas Programeve	Aktuale	Buxheti	Buxheti aktual	Projeksioni	Projeksioni	Projeksioni
Nga Grantet	2011	2012	2013	2014	2015	216
Administrata Komunale	2,242,016	2,367,178.00	2,555,540.00	2,978,536.00	3,078,017.00	3,184,436.00
Arsimi	1,742,573	2,144,892.00	2,144,892.00	2,280,777.00	2,336,545.00	2,359,679.00
Shëndetësia Primare	540,159	635,302.00	644,832.00	752,333.00	803,689.00	819,763.00
Sherbimet Sociale	26,499					
TV	368,221	400,000.00	420,000.00	441,000.00	454,230.00	463,315.00
TV te bartura	148,551		207,348.06			
Donator	247,158	226,255.42	106,843.85			
TOTALI	5,315,177	5,773,627	6,079,455.91	6,452,646.00	6,672,481.00	6,827,193.00
Rritja e buxhetit nga TV	23,494	126,801				
Granti I shtur	630,755	30,000				
Totali	5,969,426	5,930,428				

b. Parashikimi i të hyrave vetanake komunale

Të hyrat komunale realizohen në bazë të Ligjit mbi Financat e Pushtetit Lokal, Rregullores mi Tarifat dhe Ngarkesat Komunale, Rregullores mbi tatimin në Pronë si dhe dispozitave tjera ligjore të cilat përcaktojnë llojet e ndryshme të hyrave komunale me të cilat komuna ka të drejtë të caktoj dhe inkasoj mjete si të hyrat vetanake komunale qe janë pjese perberse e buxhetit.

Ne mesin e llojit te te hyrave ,pos tatimit ne prone,sipas LFPL-së,komuna inkason mjete edhe per leje biznisi (bizniset e regjistruara ne komunë),tarifat per lejen e biznesiseve profesionale ,tarifat e mjeteve motorike ,tarifat administrative komunala(sherbimet administrative), etj.

Me kornizën afatmesme të shpenzimeve 2013-2015 është parapare ndërmarrja e një varg masash duke filluar nga përpjekjet për implementimin e politikave të qëndrueshme fiskale ,zotimi i qeverisë për të ju përmbajtur rregullës fiskale sipas dokumentit të KASH të RK, rekomandimeve të FMN-se dhe zbatimi i Ligjit për Financat e Pushtetit Lokal

Bazën e të hyrave komunale e përbënë Tatimi në pronë dhe këto të hyra në strukturë janë te hyra ma te mdha ne kategorin e te hyrave komunale diku rreth 30% nga te hyrat epergjithshme komnale të cilat duhet shpenzuar ekskluzivisht në sferën e projekteve për investime kapitale në infrastrukturën rrugore, arsim,shëndetësi ujësjellës, kanalizim etj.

Pra, ne mesin e te h Hyrave Komunale jane:

- 1.Tatimi ne pronë
- 2.Tarifat për ushtrim te veprimtarisë afariste
- 3.Tarifat për lejen për shërbime profesionale

- 4.Tarifat për automjete motorike
- 5.Taksa administrative komunale
- 6.Tarifat për leje ndërtimi
- 7.Taksa për lshimin e dokumentave zyrtare
- 8 Qiraja nga objektet
- 9.Bashkë-pagesat ne shëndetësi
- 10.Taksat mbi pronen epluajtshme
- 11.Te hyrat tjera (Dhëniet nga Donatorët dhe Pjesëmarrja e qytetareve) , ne detaje shiko tabelën vijuese.

Përveç te hyrave nga tatimi ne pronë edhe taksave komunale nga biznes,që jnane një kategori te rëndësishme te hyrave vetanake komunale edhe tarifa e mjeteve motorike (pronsia e mjeteve nga personat fizik dhe juridik ne komune)janë e hyrë e konsiderushme ne strukturen e te hyrave vetanake komunale, Gjate grumbullimit te te hyrave nga biznisi kemi vu re se një numër i konsiderueshëm i bizneseve komunale nuk janë duke funksionuar me liqencë .

Taksat komunale për leje ndërtimi janë gjithashtu kategori e rëndësishme e te hyrave e qe janë te pakta ne krahasim me parashikimet . Gjatë planifikimit te kësaj kategorie komuna ende nuk është e sigurt me kategorinë e legalizimeve te objekteve te ndërtuara pa leje .(Janë identifikuar disa objekte te mëdha dhe te mesme qe presin për legalizim.

Te hyrat nga bashkë-pagesat nga konsumatorët e shërbimeve shëndetësore dhe edukative te ofruara nga komuna(ne arsim dhe shëndetësi) janë mjaft konservative, me trende ndoshta te njejta nga viti ne vit. Mbetet qe përgjegjësit e këtyre dy programeve gjatë diskutimeve buxhetore te ofrojnë te dhëna me të kompletuara mbi këto dy kategori te rëndësishme te të hyrave.

Te hyrat nga lëshimi i dokumentacioneve administrative do te janë përafërsisht të njëjtë neper vite duke u bazuara ne përvojat e viteve te kaluara karrshi kërkesave për këto dokumentacione të cilat i jane konstante.

Përmbledhja e planifikimit te hyrave aktuale vetanke 2012, 2013 dhe vlerësimet për vitin 2014 , 2015 dhe 2016 janë te paraqitura ne tabelën vijuese


Tabela 2: Plani Afatmesëm i të hyrave totale të buxhetit komunal

Komuna

Nr.	Përshkrimi	2011	2012	2013	2014	2015	2016
1	2	2	3	4	5	6	
1	TË HYRAT KOMUNALE TOTALE	5,969,426	5,930,428	5,765,264	6,452,646	6,639,521	6,793,906
1.1	TË HYRAT VETANAKE	368,221	400,000	420,000	441,000	454,230	463,315
1.1.1	Tatimi në pronë	130,000	130,000	145,000	161,000	173,230	177,315
1.1.2	Taksat komunale	116,000	122,000	136,000	138,000	141,000	144,000
	Licencat dhe lejet	8,000	10,000	12,000	12,000	12,000	12,000
	Certifikatat dhe dokumentet zyrtare	53,000	53,000	53,000	53,000	53,000	53,000
	Taksat e pajisjeve motorike	41,000	42,000	45,000	46,000	47,000	48,000
	Lejet për ndërtesa	4,000	5,000	6,000	7,000	9,000	9,000
	Taksat tjera komunale	10,000	12,000	20,000	20,000	20,000	22,000
1.1.3	Ngarkesat komunale	100,000	120,000	112,000	115,000	118,000	120,000
	Ngarkesat regullatore	30,000	45,000	35,000	37,000	38,000	38,000
	Të hyrat nga qiraja	35,000	37,000	36,000	36,000	36,000	37,000
	Bashkë-pagesat për arsim						
	Bashkë-pagesat për shëndetësi	33,000	35,000	35,500	36,000	36,000	37,000
	Ngarkesat tjera komunale	2,000	3,000	5,500	6,000	8,000	8,000
1.1.4	Të hyrat tjera-dhe kerkesat nga borgj.	22,221	28,000	27,000	27,000	22,000	22,000
1.1.5	Shitja e asetëve						
1.1.6	Grantet dhe donacionet	247,158	226,255	0	0	0	0
	Vendore						
1.2	Të huaja	247,158	226,255				
1.2.1	TRANSFERET QEVERTARE	5,237,112	5,177,372	5,345,264	6,011,646	6,185,291	6,330,591
1.2.2	Granti i përgjithshëm	2,333,418	2,397,178	2,555,540	2,978,536	3,078,017	3,184,435
1.2.3	Granti specifik për arsim	2,293,326	2,144,892	2,144,892	2,280,777	2,303,585	2,326,393
1.2.4	Granti specifik për shëndetësi	575,748	635,302	644,832	752,333	803,689	819,763
	Granti specifik per Sherbime socilale	34,620					
	Te hyrat e bartura nga viti paraprak1169	116,935	126,801				

te hyrat vetanake per vitin2011 te planifikuara kan qenë 368.221.00 euro

te realizuara gjate vitit2012 =365,117.83



Sa i përket të hyrave nga Donatorët e mundshëm për vitet në vazhdim deri në këtë moment të planifikimit të të hyrave sipas burimeve nuk kemi mundur të identifikojmë donatorët potencial.

Nga Paraqitja grafike shifet se të hyrat vetanake të komunës nga viti në vitë për vitet në vazhdim kanë një rritje pozitive. Problem mbetet inkasimi i TV të tatimit në pronë nga objektet e ndërmarrjeve shoqërore që i menagjon Agjencia Kosovare e Privatizimit. Kësisoi në vitin 2012 për shkak të këtij problemi nga TV të planifikuara në shumë prej 400,000 euro, jone realizur 365,118 euro 34,882 euro më pakë nga mjetet e planifikuara.

IV PARASHIKIMI I SHPENZIMEVE

(Vlersimet e Hershme Buxhetore 2013-2015)

Korniza Afatmesme e shpenzimeve komunale është bërë për këta sektor –Programë buxhetore komunale dhe përfshinë këtë periudhë buxhetore :

Bazuar në kufijt fillestar nga Qarkorja buxhetore e Ministrisë së Financave dhe të HV Komunale për vitin 2014-2016 totali i shpërndarjes së tyre duket kështu:

Nr	Programi	Buxheti 2011	Buxheti 2012	Buxheti 2013	Vlersimi 2014	Vlersimi 2015	Vlersimi 2016
1	Zyra e Kryetarit	120,949	125,463	123,463	124,463	135,560	155560
2	Zyra e kuvendit	89,766	103,500	103,500	108,500	110725	113700
3	Administrata dhe personeli	228,447	210,794	219,794	238,794	239183	239183
4	Ekonomi Financa	268,590	242,661	159,441	176,441	178500	180500
5	Sherbimet publike	110,954	119,715	122,215	123,215	128215	130215
6	ZLK	30,849	32,216	34,500	36,000	37000	39000
7	Bujqesi Pulltari Zhvillim rural dhe inspektion	75,320	85,352	83,472	84,472	86000	88000
8	Gjeodezi Kataster Pron	30,808	39,000	38,000	40,000	42525	44525
9	Planifikim Urban dhe Mjedis	1,977,044	1,929,680	1,848,228	2,279,224	2414679	2504881
10	Shendetrsi dhe Mirqenje sociale	680,866	754,159	755,509	865,510	873,689	879763
11	Preferanca						
12	Kultur rini sport	48,449	53,980	53,980	55,980	56,900	58900
13	Arsimi	2,307,384	2,233,907	2,223,162	2,320,047	2,336,545	2,359,679
	Gjithsejt	5,969,426	5,930,427	5,765,264	6,452,646	6,639,521	6,793,906

Mbetja e mjeteve ne vitin 2011 eshte 284,316 euro .

Nderson mbetja e mjeteve ne vitin 2012 te bartuar ne 2013 eshte 207,348.00

Specifikacioni:

Kmuna e Dragashit	Viti 2011 ne (000 euro)	Viti 2012 ne (000 euro)	Viti 2013 (ne 000 euro)	Viti 2014 Ne 000 euro)	Viti 2015 Ne 000 euro)	Viti 2016 Ne 000 euro)
	5,969	5,547	5,930	6,453	6,639	6,794

Buxheti sipas strukturës funksionale dhe ekonomike për vitin 2014-16 Qarkorja Nr 2014/1

Shpërndarja e buxhetit sipas strukturës funksionale dhe ekonomike tregon qe pjesa me e madhe e buxhetit komunal diku 57.% planifikohet dhe shfrytzohe për pagesat e te punësuarve ndërsa kategoria e shpenzimeve kapitale përben 32%

Programi	Stafi	Pagat Vjetore	Mallrat dhe Sherbimet	Komunalit	Subvencionet	Kapitale	Gjithsejt
Zyra e Kryetarit	12	79,463	10,000	0	35,000	0	124,463
Zyra e Kuvendit		93,500	15,000				108,500
Administrata	36	129,794	109,000	0	0	0	238,794
Ekonomi financa	18	70,794	45,647	60,000	0	0	176,441
Sherbimet publike em	22	108,215	12,000	3,000	0	0	123,215
ZLK	5	26,000	10,000	0	0	0	36,000
Bujqesi Pylltari dhe Inspekcio	21	77,472	7,000	0	0	0	84,472
Gjeodezi kataster	9	36,000	4,000	0	0	0	40,000
Planifikim urban dhe mjedis	8	36,200	4,000	0	0	2,239,024	2,279,224
Kultur,Rini,Sport	12	49,980	6,000	0	0	0	55,980
Kujdesi Prim.Shend.	113	574,001	126,500	30,000	0	135,009	865,510
Administrata	4	20,477	1,000	0	0	0	21,477
Sherb.Kujd.Prim.Shend	99	509,824	115,500	27,000	0	135,009	787,333
Sherbimet Sociale	10	43,700	10,000	3,000	0	0	56,700
Performanca				0	0	0	0
Arsimi	520	2,085,681	200,366	34,000	0	0	2,320,047
Administrata A.	7	33,270	4,000	0	0	0	37,270
Arsimi	513	2,052,411	196,366	34,000	0	0	2,282,777
A.Parshkollor	21	70,270		0	0	0	70,270
A.Fillor	405	1,587,722	129,366	26,000			1,743,088
A.Mesem	87	394,419	67,000	8,000	0	0	469,419
Totali	776	3,367,100	549,513	127,000	35,000	2,374,033	6,452,646

Gjatë planifikimit të kategorisë së pagave është vepruar sipas rekomandimeve të MEF-it ku pagat duhet të mbesin konstante ,pa ndryshime të dukshme pos punës jashtë orarit dhe festave.

V. INDIKATORËT E PERFORMANCES

STRATEGJIA ZHVILLIMORE PËR SEKTORËT KOMUNAL

Zyra e Kryetarit

Përmbledhje e rrjedhimeve që kërkohet të arrihen (misioni/synimet):

Deklarata e misionit: Përgatitja dhe prezantimi i të gjitha materialeve për mbledhjet e Kuvendit të Komunës dhe Komitetit për Politikë e Financa ,në kuadër të kompetencave dhe fushë veprimtarisë

të nivelit të qeverisjes locale sipas Ligjit për vetëqeverisjen Lokale dhe rregullores së Kuvendit të komunes (nxjerrja e rregulloreve ,vendimeve, udhëzimeve,etj) në funksion të qeverisjes sa më të mirë dhe efikente të gjitha drejtorive të Shërbimit civil të Komunës, gjithnjë në shërbim të gjithë qytetarëve të Komunës.

Strategjia për arritjen e rrjedhimeve të dëshiruara (aktivitetet aktuale):

Koordinimi i punëve me të gjitha drejtoritë e Shërbimit civil të Komunës, këshilltarëve të kuvendit të Komunës, Komiteteve të obligueshme dhe Komiteteve jo të obligueshme , me subjektet relevante të Nivelit Qendror dhe atij lokal, OJQ-të, biznesin, etj, me qëllim të ofrimit sa më të mirë të shërbimeve ndaj qytetarëve dhe biznesit komunal për një zhvillim ekonomik të qëndrueshëm të Komunës në përgjithësi dhe me këtë edhe të ngritjes së mirëqenies për të gjithë qytetarët e komunës.

Vlerësimi i mundësive dhe sfidave gjatë periudhës buxhetore:

Realizimi sa më i mirë dhe me plani i të hyrave buxhetore komunale do të ndikonte në realizimin e projekteve të ndryshme kapitale dhe zhvillimore të Komunës, derisa ngecja në mospërmbushjen e tyre do të ndikonte në ngadalësimin e synimeve të tyre dhe me këtë edhe në zhvillimin e tërësishëm të Komunës.

Plani i propozuar për adresimin e mundësive dhe sfidave (aktivitetet e propozuara për të ardhmen):

Një punë me efikasë e Kuvendit të Komunës, Komiteteve obligative dhe Komiteteve jo obligative për realizimin e përgjegjësisë, punëve dhe detyrave në të ardhmen do të ndihmonte në përshpejtimin e realizimit të programeve zhvillimore në Nivelin komunal .

ADMINISTRATA E PERGJITHSHME Strategjia e Drejtorise

Përmbledhja e rrjedhimeve që kërkohet të arrihen(misioni/synimet):

Ndihmon kuvendin dhe komitetet dhe ju siguron të gjitha raportet dhe informacionet e ndryshme. Ndihmon Kryetarin dhe bordin për mbarëvajtjen e punëve që i përkasin lëmise së DAP. Zbaton të gjitha ligjet dhe vendimet e komunes në regjistrimin e Lindjeve ,kurorëzimit,martësës dhe vdekjes, regjistrimin e statusit dokumentacioneve civile,përgatit Raportin e punës dhe programin-objektivat e kësaj drejtorie,menagjon me personelin e stafit civil, përcjell punën e shërbimit të prokurimit e tj . Kryen edhe punë tjera që i ngarkohen nga kuvendi .

Strategjia për arritjen e rrjedhimeve të dëshirueshme (aktivitetet aktuale)

Koordinon punën me zyrat e kësaj drejtorie duke u nisur nga zyra pritëse ,z personelit,e shërbimin e autoparkut, regjistrimin civil. Zyret Ligjore dhe integritet europjane dhe zyra e prekurimit .

Vlerësimi i mundësive dhe kercnimeve gjatë periudhës buxhetore :

Mosrealizimi i detyrave do të lëndon të drejtat e qytetarëve kurse në aspektin buxhetor të hyrave do të reduktonin realizimin e planeve të kësaj komune për pjesën e buxhetit për TV.

Plani i propozuar për adresimin e mundësive dhe kercnimeve (aktivitetet e propozuara)

Te shtohet koordinimi me sektorët e kësaj drejtorie për një punë sa më kualitative në shërbim të qytetarit

Strategjia e Drejtorisë

Drejtoria për Ekonomi Financa

Përmbledhje e rrjedhimeve që kërkohet të arrihen (misioni/synimet):

Deklarata e misionit:-Në bashkëpunim me ZKF bënë përgatitjen dhe prezantimin e buxhetit komunal, menaxhimin e Buxhetit dhe Financave të Komunës, përgatitjen e raporteve periodike dhe pasqyrat financiare vjetore , i siguron Drejtoritë me shërbimet e kontabilitetit dhe menaxhimin e shpenzimeve dhe informon menaxherët kryesor komunal me aktivitetet e ndërlidhura me buxhetin e komunës.

Strategjia për arritjen e rrjedhimeve të dëshiruara (aktivitetet aktuale):

Koordinimi i punëve dhe aktiviteteve me të gjithë Drejtorët e Komunës dhe Organizatat buxhetore komunale për përcaktimin e kriterëve për ndarjen e Buxhetit konformë limiteve të përcaktuara nga MF-i të dhëna përmes qarkoreve buxhetore, zhvillimi i KAB –it komunal sipas standardeve me të larat për nivelin e administratës lokale , bashkëpunimi i ngushtë me Ministrinë e Financave dhe të gjitha ministrit e Republikës së Kosovës në sferën e buxhetit dhe financave.

Vlerësimi i mundësive dhe kërcënimeve gjatë periudhës buxhetore:

Mos realizimi i Te hyrat vetjake komunale janë një ndër kërcënimet me serioze për realizimin e planit të buxhetit komunal si pasojë mund të vijë deri te reduktimi i investimeve kapitale të parapara me buxhet nga TV te komunes ,gjithashtu edhe reduktimet eventuale nga qeveria qendrore mund te paraqet kërcënim për realizimin e planit.

Plani i propozuar për adresimin e mundësive dhe kërcënimeve (aktivitetet e propozuara për të ardhmen):

Qëndrueshmëria buxhetore dhe menaxhimi me efikasitet dhe efektivitet sipas dinamikës së rrjedhës së parasë i shpenzimeve për të gjitha kategoritë ekonomike dhe sidomos ato që kanë të bëjnë me zhvillimin ekonomik-investimet kapitale. Bashkëpunimi i ngushtë në mes të MEF-it dhe të gjitha drejtorive komunale me drejtorin për buxhet e financa.

Objektivi i Drejtorisë

Ngriitja e kapaciteteve dhe koordinimi tyre në grumbullimin e të hyrave vetanake të planifikuara ,

Strategjia e Drejtorisë

Drejtoria për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale

Drejtoria për shëndetësi mirëqenia sociale

Deklarata e misionit: DSHMS ka për mision të vetin të sigurojë, përmirësojë dhe ofrojë qasje në shërbime cilësore të kujdesit primar shëndetësor, staf mjekësor të shkathët dhe programe inovative si dhe të zhvillojë sistemin e ofrimit të mbrojtjes parësore shëndetësore sa më kualitative duke u bazuar

në nevojat e popullatës në tërë territorin e komunës dhe përkujdesjen sociale të gjithë banorëve, veçmas të atyre me status të rëndë social, gjithmonë në kuadër të mundësive buxhetore dhe profesionale. Kjo Drejtori funksionin e saj e kryen përmes Kujdesit primar shëndetësor, qendrës për punë sociale dhe Administratës. Bashkëpunimin e ngushtë në mes të programeve komunale, Ministrisë së Shëndetësisë, Ministrin e Punës dhe Mirëqenies sociale, MEF-it si dhe donatorët të mundshëm të cilit shprehin interes për bashkëpunim.

Kujdesi parësor shëndetësor

Deklarata e misionit: Synimi kryesor është ofrimi i kujdesit parësor shëndetësor i gjithë popullatës pa dallim moshe, gjinie race, religjioni.. Te gjitha shërbimet shëndetësore kryhen përmes QKMF, QMF dhe ambulancave ku ofrohen këto shërbime: shërbimet e mjekësisë familjare, kujdesit të fëmijëve, kujdesit të grave në maternitet, shërbimet stomatologjike, vaksinimi dhe emergjenca

Qendra për punë sociale

Deklarata e misionit: Kjo qendër kryen këto shërbime: shërbimet e asistencës sociale, shërbimet sociale dhe shërbimet administrative financiare.

Dhënia e **asistencës sociale** behet në baze të ligjit 2003/15 përmes aplikimit që me vonë komisioni pas verifikimit të gjendjes në terren vendos për mbështetje.

Shërbimet sociale kryhen sipas nevojave të qytetareve. Janë mbi 50 lloje të shërbimeve: si shërbimet për fëmijë jetim, braktisja e fëmijëve, fëmijët pa përkujdesje, adoptimi i fëmijëve sjellja asociale, përkujdesja për të moshuarit pa mbështetje të prindërve etj.

Numri i stafit 10

Administrata

Deklarata e misionit: Administrata është përgjegjëse për sigurimin e personelit të drejtorisë me udhëzime, politika dhe procedura për menaxhimin dhe implementimin e aktiviteteve, menaxhimin e buxhetit dhe të financave të drejtorisë dhe mbikëqyr punën dhe aktivitetin e përgjithshëm të Shëndetësisë primare përmes QKMF, QMF dhe ambulancave në terren

Strategjia për arritjen e rrjedhimeve të dëshiruara (aktivitetet aktuale):

Koordinimi i mirë i aktiviteteve nëpër të gjitha QMF dhe AMF në qytet dhe vendbanimet rurale duke ofruar shërbime mjekësore parësore sa më afër popullatës. Kjo do të arrihet përmes:

- Përmirësimi i menaxhimit në drejtim të caktimit të qartë të prioriteteve në lidhje me kujdesin shëndetësor si dhe involvimin e partnerëve në çështjet ku është e nevojshme një qasje gjithëpërfshirëse,
- Vendosja e një agjende të saktë në lidhje me aktivitetet, qasje stimulativë në aplikimin e njohurive ekzistuese si dhe ofrimin e mundësisë për zgjerim të njohurive dhe shkathtësive për stafin, përmes zhvillimit të vazhdueshëm profesional.
- Vendosja e normave dhe standardeve si dhe promovimi dhe monitorimi i implementimit të tyre duke pas parasysh mjekësinë e bazuar në të dhëna bashkëkohore dhe artikullimin e çështjeve që kanë të bëjnë me etikën profesionale.
- Ofrimi i mbështetjes teknike, inicimin e ndryshimeve dhe ndërtimin e kapaciteteve institucionale të qëndrueshme.
- Monitorimi i gjendjes shëndetësore si dhe vlerësimin e trendëve shëndetësore në komunë.

Çka mund të arrijmë:

- Reduktimin e problemeve shëndetësore, sociale dhe ekonomike (sëmundja ndikon drejtpërdrejtë në gjendjen ekonomike).
- Parandalimin e sëmundjeve ngjitëse
- Parandalimin dhe zvogëlimin e sëmundshmërisë, paaftësisë dhe vdekjet e parakohshme nga sëmundjet kronike, çrregullimet mendore, dhuna dhe lëndimet,
- Zvogëlimi i morbiditetit dhe mortalitetit dhe përmirësimi i shëndetit gjatë fazave kyçe të jetës duke përfshirë shtatëzaninë, shëndetin reprodaktiv, të fëmijës dhe promovimin e jetës aktive dhe të shëndetshme të individve,
- Zvogëlimi i pasojave të situatave emergjente me qëllim të minimizimit të efektit të tyre në jetën sociale dhe ekonomike,
- Promovimi i jetës së shëndetshme dhe parandalimi apo reduktimi i faktorve të rrezikut për shëndetin si: duhani, alkooli, drogat dhe substancat tjera psikoaktive, dieta, mosaktiviteti fizik etj.
- Adresimi i faktorve ekonomik dhe social dhe programeve që e akcentojnë barazinë dhe integrojnë çasjet pro rastev me varfëri të skajshme, baza gjinore dhe të bazuara në konventat e të drejtave të njeriut.
- Promovimi i ambientit të shëndoshë duke adresuar faktorët ambiental që kërcenojnë shëndetin publik.
- Përmirësimi i ushqyeshmerisë në kuptim të ushqimit të shëndoshë.

Si të arrihet?

Duke marrë parasysh faktin së shërbimet e KPSH ofrohen në Institucionet Publike, politikat qendrore kanë ndikim të madh në zhvillimin e këtyre shërbimeve. Strukturat e qeverisjes lokale kanë për obligim të mbështesin aktivitetet e KPSH në kuadër të mundësive bugetore. Komuna e Dragashit, si komunë me të hyra vetanake të ulëta, me vështirësi mund të përballon nevojat e qytetarve për shërbime shëndetësore. Ajo që mund të arrihet është:

- Shpërndarja e shërbimeve të kujdesit shëndetësor sa më afër pacientit (aktivizimi i plotë i ambulancave të mjekësisë familjare – mjeku çdo ditë pune në ambulancën familjare më të afërt)
- Punësimi i mjekve me qëllim të arritjes së kuotës së paraprë me strategji shëndetësore : në 2000 banorë një mjek (duke mos pranuar staf teknik të ri – infermier, në vend të atij që pensionohet apo largohet nga vendi i punës për ndonjë arsye tjetër dhe duke i zëvendësuar me mjek të rinj)
 - Zëvendësimi i stafit teknik dhe administrative që largohet (pensionohet) zëvendësohet me staf mjekësor profesional,

Projekte kapitale për vitin 2013:

- Furnizimi me paisje bashkohore),

- Renovimi i objekteve shëndetësore dhe
- Furnizimi me shërbime, barëra dhe preparate të domozdoshme.

Vlerësimi i mundësive dhe kërcënimeve gjatë periudhës buxhetore:

